

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA PODUJEVE**, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtarin Binak Duqi, dhe sekretaren juridike Xhevide Selmani, ne çështjen juridike të paditëses H.A.B. nga G., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjorë prindi N. B. kurse që të dy i përfaqëson i autorizuari F. P. nga P. me autorizim, kundër të paditurës KS "S." nga P., të cilën e përfaqëson me autorizim A. P., baza e kontestit kompensim dëmi, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik, në prezencën e të autorizuarit të paditëses e në mungesë të përfaqësuesit të paditurës me dt.14.10.2013 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. PJESERISHT** aprovohet kërkesëpadia e paditëses H.B. nga G., si e **BAZUAR** dhe **DETYROHET** e paditura KS "S." nga P., që paditëses të ia paguaj shumat si vijon:

- në emër të dëmit jo material:
- për shkak të dhimbjeve fizike shumën prej 2000 €,
- për frikën e përjetuar shumën prej 2000 €,
- për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallë prej 5% shumën prej 1500 €,

**Gjithsejtë** shuma e aprovuar është shuma prej 5500 €.

- Përtej shumës së aprovuar shuma prej 25.000 € refuzohet si e pa bazuar.
- Në emër të dëmit material ju aprovuan këto shuma:
- Për ushqim të përforcuar shuma prej 210 €,
- Për ndihmë dhe perkujdes i personit të tretë shuma prej 150 €.
- **Refuzohet** si e pa bazuar kërkesa për kompensimi ne dëmit material për rehabilitim klimaterik për shumën prej 350 €.

Sa i përket shëmtimit trupor i autorizuari i paditëses ka hekur dorë nga kjo kërkesë për kompensim dëmi pasi që e njëjta nuk është konstatuar nga ekspertët mjekoligjorë.

**Gjithsejtë** shuma e aprovuar për dëmin material është shuma prej 360 €.

Shuma e tërësishme e aprovuar si e bazuar për paditësen për kompensim dëmi jo material dhe material është shuma prej 5860 €.

**Përtej** shumës së aprovuar shuma prej 25.350 €, refuzohet si e pa bazuar për kompensimin e dëmit jo material dhe material.

**Detyrohet** e paditura KS "S.", që shumën prej 5860 € të ia paguaj paditëses H. B. nga G. me kamatë si që e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjete të deponuara mbi 1 vit pa destinim të caktuar duke filluar prej ditës së ekspertizës me dt. 25.07.2013 gjer në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet e paditura që paditëses të ia kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 781 €, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përbarimit me dhunë .

## **A r s y e t i m**

Paditësja e mitur H.B. e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjorë prindi i saj N., dhe që të dy të përfaqësuar nga i autorizuari i tyre F. P., nëpërmes tij kanë deklaruar se me dt. 21.04.2011, rreth orës 16, 15 h në fshatin G. në afërsitë të ambulancës së fshatit në magjistralen Prishtinë- Podujevë ka ndodhë fatkeqësi komunikacioni ku automjeti me targa *numër i targave...*, i markës VW golf 6, që e ngjiste H. S. e ka goditur këmbësoren H. B. i cili duke mos pasur kujdesin e huaj ndaj sajë me pjesën e parë të anësore së majtë e godet atë me që rast i shkakton lëndime trupore.

Automjeti që ka shkakuar aksidentin ishte i siguruar tek e paditura. Paditësja në aksident ka pësuar dhembje fizike , frikë , zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë ka pas nevojë për ndihmë dhe ushqim të përforcuar si dhe për rehabilitim .

Andaj gjykatës i propozoi që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoi në tërësi si të bazuare.

Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Përfaqësuesja e të paditurës në përgjigje në padi e ka kontestua bazën juridike kurse në seancat e dt. 27.06.2013, dhe 14.10.2013 nuk ka prezantuar edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt dhe përmes telefonit i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se gjendet në gjykatë në Drenas dhe propozon që të vazhdohet shqyrtimi kryesor në mungesë të tij.

Në seancën e dt., 25.07.2013, ka prezantua përfaqësuesi A. P. i cili ka mbetur pranë përgjigjes në padi.

Gjykata për të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të gjithanshme gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore në procedurën e provave bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave:

U lexua raporti i policisë me nr. 2011-AR-0399, dt. 21.04.2011, si dhe raporti i hetuesit e skica e vendit të ngjarjes me të njëjtën datë dhe nr. Fletlëshimi me epikrizë nga QKUK –klinika e neurokirurgjisë me nr. Amze 2805, raporti i specialistit me nr. 879 dt. 13.05.2011 raporti i qendrës spitalore me nr. 1641 dt.28.10.2011, nr. 475 dt. 28.04.2011, raporti i specialistit të dt. 13.05.2011, raporti i QKMF Podujevë, dt. 13.05.2011, raporti i qendrës spitalore nr. 860 dt. 28.04. procesverbali i shqyrtimit përgatitor i dt. 27.06.2013, i seancës kryesore i dt. 25.07.2013, ku e kanë dhënë mendimin ekspertët mjekoligjorë. Aktakuza e PPK nga Prishtina, PP.nr. 2269/11, dt. 20.09.2011, kundër H. S. si shkaktar i aksidentit, mendimi i ekspertit të komunikacionit A. K. ti dhënë në GJPP. dt. 27.07.2011 si dhe precizimi i kërkesëpadisë i bërë nga pala paditëse me dt. 01.08.2013.

Gjykata duke i vlerësua provat një gaz një e të gjitha së bashku konformë nenit 8 të LPK, gjeti dhe vërtetoi këtë gjendje faktike:

Është kontestuese baza juridike nga e paditura në përgjigje në padi dhe seanca e dt. 25.07.2013, për ti hequr dilemat lidhur me këtë gjykata nga provat e administruara në procedurën e provës dhe thëniet e palës paditëse gjeti se ekziston baza juridike për

kompensim dëmi dhe përgjegjësin e të paditurës. Sepse i siguruari i të paditurës H.S.ka shkaktuar aksident me automjetin e tij VW “Golf 6”, me targa numër i targave..., kurse në anën tjetër si pjesëmarrës në komunikacion kemi këmbësoren e mitur H. N.B. e moshës 8 vjeçare.

Automjeti ishte i siguarur te e paditura me nr. Police 0002566296 me validitet deri me 15.06.2011. se paditësja në këtë aksident ka pësuar lëndime kjo vërtetohet nga raporti policor , rrëfimi mbi aksidentin i hetuesit dhe skica e vendit të ngjarjes me nr. 2011-AR-0399 dt. 21.04.2011, mendimi i ekspertëve mjekoligjor A. T. ortoped dhe N. M. psikiatër, po ashtu kjo vërtetohet edhe nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit të dhënë në Gjpp.nr.93.11 nga eksperti A. K. me dt. 25.07.2011. i cili ka konstatuar se kanë kontribut në aksident si ngasësi i veturës dhe W golf 6 por dhe këmbësoren e mitur e cila ka trupor rrugën në pjesën ku nuk ka pasur vend kalim për këmbësoren dhe pa u siguarur mirë se me një veprim të tillë nuk do e rrezikoi veten dhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacion. Sa i përket vozitësit ai ka tejkallua shpejtësinë mbi atë të lejuar të cilën e ka vozitur 56 km/h, kurse aty ka qenë e kufizuar shpejtësia në 50 km në orë, po ashtu a i ka pas mundësi ta vërejë këmbësoren që po e truponte rrugën në largësi prej 68 metra dhe nuk i ka ndërmarrë veprimet e duhura për ta evituar përplasjen e këmbësoren dhe se me shpejtësinë që e ka zhvilluar ngasësi ka pas mundësi teknike dhe ka mundur ta evitoi aksidentin me frenim të vrullshëm. Andaj sipas gjykatës ngasësi i veturës është ai që është dashtë ti kushtoi më shumë vëmendje dhe kujdes këmbësorëve posaçërisht kur janë në pyetje fëmijët sepse lëvizjet e tyre janë shpeshherë dhe munden me qenë të paparashikuara dhe të pa kontrolluara mirëpo ata janë fëmijë prapë se prapë.

Baza vërtetohet nga aktakuza e ngritur ndaj të siguarurit të paditurës nga PPK Prishtinë me nr. 2269-2/11 dt. 20-09.2011.

Se ka përgjegjësi juridike për kompensim e paditura rrjedh sepse polica e sigurimit ka qenë valide në kohën e aksidentit dhe nga këto bie përgjegjësia e sajë për sigurimet e detyrueshme nga auto përgjegjësia që u shkaktojnë dëm personave të tretë sipas rregullit 3 të BQK.

Mirëpo gjykata përgjegjësinë dhe kontributin e paditëses së mitur e pati parasysh me rasti ne aprovimit të shumave për kompensimin e dëmit jo material dhe material .

Shumat e aprovuara nga gjykata pasi që u vërtetua me prova baza juridike dhe përgjegjësia e të paditurës për kompensim min e dëmit gjykata i bazoi në mendimet e ekspertëve mjekoligjorë dr. A. T. ortoped dhe dr. N. M. psikiatër. QKUK Prishtinë të dhënë në gjykatë në procesverbalin e dt. 25.07.2013, nga raportet mjekësore LMD, praktika gjyqësore kontributet e pjesëmarrësve në komunikacion sidomos kontributi i paditëses vlerësuar sipas ekspertit t komunikacionit , praktika gjyqësore edhe për kundër mungesë së të paditurës gjykata i pati parasysh këto rrethana si dhe moshë e re e këmbësores së lindur me 2003.

Nga mendimi i ekspertit të ortopedisë dr. A. T. vërtetohet se paditësja e mitur ka pësuar lëndime të rënda trupore si thyerje lineare e kafkës së regjionit F-b të majtë , ndrydhje e gjurit të djathtë, hematom përreth syrit të majtë me që rast i janë shkaktuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë disa sekonda, të intensitetit të rëndë tri ditë kohë pas kohe, intensitetit të mesëm 15 ditë çka e dëshmon edhe terapia e ordinar, dhembje fizike të intensitetit të ulët që kanë zgjatur edhe për tre muaj, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallë prej 5%, e manifestuar me dhembje koke ,

kufizim të lëvizjeve në disa drejtime të qafës, hecje të disekuilibruar ndonjëherë, zvogëlim aftësisë për koncentrik dhe për të mbajtur mend. Ka pas nevojë paditësja për ndihmë të huaj për 15 ditë për shkak të lëndimeve të kokës dhe për shkak të imobilizimit të detyruar në këmbën e djathtë, për ushqim të përforcuar ka pas nevojë për 21 ditë, i pasur me vitamina dhe minerale si dhe për rehabilitim për vitin e parë 2 herë nga 7 ditë. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallën prej 5%, është i përhershëm ka deklaruar eksperti.

Sa i përket frikës ekspertja e psikiatrisë dr. N. M. padeklaruar se paditësja ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë 3 ditë, frikë sekondare të intensitetit të ulët për 12 muaj, dhe aktualisht ende herë pas herë vërehet se ka frikë, nervozë dhe pasiguri për pjesëmarrje në komunikacion .

Andaj në precizimin e kërkesëpadisë pala paditëse ka kërkuar për dhembje fizike shumë prej 11.000 € kurse gjykata i aprovoi shumë prej 2000 €, për frikën e përjetuar ka kërkuar shumë prej 7500 € kurse gjykata i aprovoi shumë prej 2000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë në shkallë prej 5% ka kërkuar shumë prej 12.000 € kurse gjykata i aprovoi shumë prej 1500 €, për shëmtim trupor pala paditëse ka hequr dorë pasi që nuk u vërtetua nga eksperti se paditësja e mitur ka pësuar shëmtim. Për ndihmë në huaj gjykata i aprovoi shumë prej 150 €, për arsye se paditësja ka qenë e mitur dhe ka mbajtur imobilizim në këmbën e djathtë si dhe ka pas dhimbje koke andaj gjykata vlerësoi se ajo vërtetë ka pas nevojë për ndihmën e tjetrit , për ushqim të përforcuar iu aprovua shuma prej 210 €, duke pas parasysh moshën e sajë se ishte fëmijë dhe për të u shëruar më shpejtë dhe për të iu forcuar eshtrat e këmbës nga lëndimet dhe fakti se iu është dashur ushqim më i pasur me vitamina dhe minerale se sa ushqimi i zakonshëm.

Ju refuzua kërkesa për kompensim dëmi për rehabilitim klimaterik në shumë prej 350 €, edhe pse eksperti ka vlerësuar se ka pasur nevojë por pala paditëse me prova nuk e vërtetoi rrethanën se ka qenë në ndonjërin prej banjave apo të ketë bërë ushtrime fiziatrike duke i mbuluar këto me shpenzimet e bëra me fatura.

Shumat e precizuara sipas gjykatës ishin tejet të larta dhe jo në harmoni me lëndimet e pësuar të paditëses së mitur, as me kriteret e KS , LMD , praktikën gjyqësore. Mirëpo gjykata i aprovoi shumat si që janë të cekura në dispozitivë të aktgjykimit dhe në arsyetim të aktgjykimit më lartë si shuma të drejta dhe satisfacion real me lëndimet e pësuar mirëpo gjithmonë duke u bazuar edhe me kontributin e paditëses së mitur në aksident të konstatuara me ekspertin e komunikacionit , por përgjegjësi më të madhe për rastin duhet bartur ngasësi i automjetit si i siguruar i të paditurës dhe shumat e aprovuara janë të bazuara dhe në mendimet e ekspertëve mjekoligjorë, natyrën dhe llojin e lëndimeve frikën e përjetuar , gjatësia e tyre me dhembje të përjetuara të kualifikuara nga ekspertët.

Gjykata edhe për kundër mungesës së përfaqësuesit të paditurës pati parasysh përgjigjen e dhënë në padi të sajë dhe deklarimin në seancën e dt. 25.07.2013, të përfaqësuesit të sajë.

Shumat gjithashtu janë kompensim real me të mirën e shkelur të paditëses dhe të bazuar në LMD nenin 200 al.1. dhe 2 lidhur me nenin 323 të LPK, qëllimi i kompensimit që i shërben që ai të mos jetë pasurim i pabazë për njërin palë dhe në dëm të palës tjetër por të jetë në pajtim me natyrën e sajë dhe qëllimin shoqërorë.

Andaj pa dyshim u vërtetua nga provat e administruara se lëndimet e paditëse së mitur H.B. janë rezultat i aksidentit dhe ekziston lidhja kauzave e lëndimeve me rastin e siguruar, andaj e paditura e mban përgjegjësinë për kompensim dëmi por me zvogëlim të shumave edhe për kontributin e paditëses në aksident si që është e paraparë me kriteret e kompanive të sigurimeve të miratuara nga vetë e paditura rregullin 3 të BQK, nenin 200 të LMD si dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit.

Pjesa refuzuese u bazua në atë se shumat e kërkuara ishin shumë të larta dhe jo në harmoni me lëndimet po ashtu kërkesa për rehabilitim klimaterik ju refuzua paditëses se e njëjta nuk u argumentua me prova për shpenzimet e bëra nga ajo me fatura si që e parasheh edhe neni 3 i LPK në të cilën thuhet se pala paditëse ka për detyrë të i paraqes faktet mbi të cilat i mbështet kërkesat e veta dhe të propozoi prova me të cilat konstatohen ato fakte.

Kurse iu aprovuan shumat për dëm material për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar sepse gjykata është e mendimit se ajo vërtetë në moshën që ka pas kur ka pësuar aksident si fëmijë gjatë qëndrimit të sajë në spital por edhe pas daljes nga spitali ka pas nevojë për ndihmë dhe ushqim të përforcuar pasi që e njëjta ka mbajtur edhe imobilizim në këmbë dhe ka pas lëndime në kokë, mirëpo i është dashur që të përdor ushqim të përforcuar se sa ai i zakonshmi me qëllim të shërimit më të shpejtë dhe forcimit të eshtrave.

Shumat e aprovuara gjykata i bëri dhe konformë neneve 154,155,173,174 dhe 200 të LMD, kurse e refuzoi shumën tjetër si të pabazuar dhe të pa vërtetua me prova në procedurë nga paditësja si që u cek në diapozitiv të aktgjykimit.

Gjykata vendimin lidhur me shpenzimet e pro cedues që ato ti bartë pala e paditur e mori konformë neneve 449,450,452 dhe 453 të LPK, duke i aprovua shumë në tërësisht prej 781 € dhe atë 78 € për padi 3 përfaqësime nga 101 € gjithsejtë 303 €, dy ekspertiza mjekoligjore nga 150 € 300 €, si dhe 100 € për taksë gjyqësore 50 € për padi dhe 50 € për aktgjykim, kurse i refuzoi shumën tjetër si të pabazuar.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE- DEGA PODUJEVE**  
**C.nr.200/2011 të dt. 14.10.2013**

**Gjyqtari:**  
**Binak Duqi**

**KESHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar  
Ankesa në afatin prej 15 ditësh, në Gjykatën  
e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.